



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM ,2020-2022

“Tropoja, Porta e Alpeve Shqiptare, një zonë me natyrë të spikatur që do të jetë qendra turistike e rajonit, me qytete dhe fshatra të strukturuar e të gjelbër, një komunitet me identitet të fortë, që do të ofrojë turizëm natyror të qendrueshëm me shërbime të larmishme cilësore bazuar në vlera e tradita autoktone”

Program i Buxhetit Afatmesëm 2020-2022

Bashkia Tropoje /Qarku Kukës

Tabela e lëndës

1	Vështrim i përgjithshëm	5
1.1	<i>Situata e njësisë së vetëqeverises vendore.....</i>	5
	<i>Burimi i informacionit: Plani i Përgjithshëm Vendor / Plani i Zhvillimit Strategjik (PPV/PZhS)</i>	5
1.2	<i>Çështje kryesore për projektet dhe politikat e NJQV-së.....</i>	5
1.3	<i>Informacion financiar themelor</i>	5
2	Orientimi afatgjatë njësisë së vetëqeverises vendore	5
2.1	<i>Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territoriale</i>	5
2.2	<i>Sfidat kryesore të zhvillimit</i>	5
3	Projektet kryesore të PBA-së 2019-2021	5
3.1	<i>Paraqitja e projekteve kryesore – arsyet dhe përfituesit.....</i>	5
3.2	<i>Plani i shpenzimeve kapitale /projektplani 2019-2021</i>	5
4	Informacion financiar	7
4.1	<i>Supozimet e planifikimit</i>	7
4.2	<i>Burimet e të ardhurave.....</i>	7
4.3	<i>Shpenzimet.....</i>	7
4.4	<i>Buxheti total</i>	7
4.4	<i>Informacion financiar shpesë.....</i>	7
4.4.1	<i>Huamarrje</i>	7
4.4.2	<i>Të prapambetura.....</i>	7
4.4.3	<i>Treguesit financiarë.....</i>	7
4.4.4	<i>Rreziqet financiare.....</i>	7
5	Informacion për programet buxhetore.....	8
011:	<i>Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme.....</i>	8
013:	<i>Shërbime të përgjithshme.....</i>	11
031:	<i>Shërbimet policore</i>	12
032:	<i>Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri.....</i>	14
036:	<i>Rendi publik dhe masat e sigurisë.....</i>	15
041:	<i>Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës</i>	17
042:	<i>Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia</i>	18
045:	<i>Transporti.....</i>	20
047:	<i>Industri të tjera.....</i>	22
051:	<i>Menaxhimi i mbetjeve</i>	24

052: Menaxhimi i ujërave të zeza.....	25
053: Reduktimi i ndotjes.....	27
056: Mbrojtja mjedisore.....	28
061: Zhvillimi i strehimit.....	30
062: Zhvillimi i komunitetit.....	31
063: Furnizimi me ujë.....	33
064: Ndriçimi i rrugëve.....	34
072: Shërbimet ambulatorë.....	36
081: Shërbimet rekreative dhe sportive.....	37
082: Shërbime kulturore.....	39
091: Arsimi bazë dhe parashkollor.....	40
092: Arsimi i mesëm.....	42
096: Shërbimet plotësuese në arsim.....	43
101: Sëmundje dhe paaftësi.....	45
102: Të moshuarit.....	47
104: Familje dhe fëmijët.....	49
105: Papunësia.....	52
106: Strehimi.....	54
107: Ndihma ekonomike.....	55
6 Monitorimi i zbatimit të strategjisë.....	57
6.1 Hyrje – rezultati i përgjithshëm dhe përfundime.....	57
6.2 Lista e masave strategjike për çdo fushë prioritare – statusi i zbatimit.....	57
7 Shtojcë.....	59
7.1 Regjistri i asetëve.....	59
7.2 Huatë.....	61
7.3 Garancitë dhe vëllimi i tyre financiar.....	61
7.4 Kontratat Lizing.....	61
7.5 Kontratat Qiraje.....	62
7.6 Kontrata me të tretë / Jashtëkontraktimi (outsourcing).....	62
7.7 Konçesione dhe PPP.....	62
7.8 Shoqëritë në pronësi të njësisë vendore.....	63
7.9 Paketa fiskale.....	63
7.10 Vlerësimi i shpenzimeve të planifikuara si pjesë e paketës fiskale.....	63
7.11 Përshkrimi i metodologjisë së përlogaritjes së të ardhurave.....	63
7.12 Plani i fluksit monetar.....	63

Të përgjithshme mbi Bashkinë

1.1. Territori i Bashkisë Tropojë

Bashkia e Tropojës me qendër në qytetin e Bajram Currit, ndodhet në Verilindje të Republikës së Shqipërisë. Kufizohet në veri me Malin e Zi, në lindje me Kosovën, në jug me Bashkinë e Hasit dhe atë të Fushe-Arresit, në perëndim me Bashkinë e Malesisë së Madhe, të Shkodrës dhe atë të Vaut të Dejës.

Rrethi i Tropojës ka një sipërfaqe të përgjithëshme prej 1043 km katror. Distanca e Bajram Currit nga kryeqyteti i vendit Tiranë është 262 km.

Emri i zonës lidhet me fshatin Tropojë i cili, nga viti 1925 e deri në vitin 1952, ka qenë qendra administrative e këtij rrethi. Që nga viti 1952, qendër administrative e rrethit u bë qyteti Bajram Curri, i cili u ndërtua në ish fshatin Kolgecaj, në Pellgun e Tropojës, rrëzë bjeshkëve të Bishevës dhe Ponarit. Qyteti ka marrë emrin nga Heroi i Popullit Bajram Curri (1862-1925), figurë e shquar shqiptare për pavarësi dhe liri si para dhe pas shpalljes së pavarësisë së vendit.

Tropoja është një zonë malore. Pjesën më të madhe të sipërfaqes e zënë malet e larta. Në këtë zonë ndodhet edhe maja e dytë më lartë në Shqipëri, Jezerca me 2693 m. Lartësia mesatare e rrethit është ndër më të lartat në Shqipëri—1105 metër mbi nivelin e detit.

Klima në Tropojë është malore në zonën e Alpeve dhe mesdhetare kontinentale në pjesën tjetër. Temperatura mesatare në pellgun e Tropojës është 11.5°C, 0.2°C në dimër dhe 21°C në verë. Sasia mesatare vjetore e reshjeve është rreth 1735 mm. Gjatë muajve të dimrit bie borë, sidomos në zonat më të larta. Ka maja malesh ku dëborat nuk shkrihet asnjëherë. Erërat fryjnë nga veriu—“Veriu i zi” nga verilindja nëpërmjet Qafës së Morinës dhe “Veriu i bardhë” nga veriu nëpërmjet luginës së lumit të Gashit—që sjellin masa ajri të ftohta dhe “Era” që fryn nga jugu përgjatë Luginës së Valbonës dhe sjell masa ajri të ngrohta e me lagështi.

1.2. Historia, kultura, traditat dhe atraksionet kryesore

Tropoja, ose sic njihet tradicionalisht Malësia e Gjakovës, është banuar që në periudhën e hershme të hekurit. Në kohën e ilirëve, kjo zonë ka qenë e populluar nga fisi i Dardanëve. Rosuja ka qenë qendra më e njohur qytetare në kufirin mes labeatëve dhe dardanëve dhe daton 400 vjet para lindjes së Krishtit. Gjatë Perandorisë Osmane, Tropoja ishte pjesë e Vilajetit të Kosovës. Para Luftës së Dytë Botërore, Tropoja së bashku me Hasin dhe Kukësin ishte pjesë e Prefekturës së Kosovës që ishte një nga 10 zonat administrative të Shqipërisë. Deri në fillimin e viteve 1990 (1959-1991), Tropoja ishte një nga 26 rrethet e vendit. Aktualisht, ajo është pjesë e qarkut të Kukësit.

Përcaktimi i kufijve në vitin 1913 la Kosovën jashtë Shqipërisë. Tropojën e ndau nga tregu i saj historik/tradicional—Gjakova. Tropoja/Malësia e Gjakovës ka pasur gjithmonë lidhje të ngushta të gjithanshme me qytetin e Gjakovës që para 1913 ishte ndër qendrat më të rëndësishme zejtaro-tregëtare të Vilajetit të Kosovës. Vendosija e kufirit shtetëror përgjithësisht armiqësor midis Shqipërisë dhe ish-Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene dhe pasueses së saj ish-Jugosllavisë dhe vështirësia për të komunikuar lirisht me pjesën tjetër të vendit për shkak të maleve të larta dhe infrastrukturës rrugore të keqe, e izoloi Tropojën për dekada dhe vështirësoi edhe më shumë gjendjen ekonomike dhe shoqërore të banorëve të saj. Me çlirimin e Kosovës në vitin 1999, lidhjet tradicionale dhe ndërveprimi me Gjakovën dhe pjesën tjetër të Kosovës u rivendosën. Tani popullsia e Tropojës ka mundësinë e aksesit në tregjet, shkollat, apo spitalet e Kosovës. Tropoja ndodhet rreth 260 km larg Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë, dhe 120 km larg Prishtinës, kryeqytetit të Kosovës. Edhe rruga më e lehtë për në Tiranë, tani kalon nëpërmjet Kosovës—Bajram Curri-Gjakovë-Prizeren-Kukës-Tiranë. Ndërtimi i Rrugës së Kombit (Shqipëri) dhe autostradës “Ibrahim Rugova” (Kosovë) e ka lehtësuar transportin për Tiranë dhe Prishtinë.

Tropoja është e njohur për bukuritë dhe pasuritë e saj natyrore. Alpet në zonën e Tropojës përbëhen nga male të larta dhe të thepisur dhe shumë tërheqës si pasojë e veprimit të akullnajave dhe erozionit, me kullota të pasura alpine. Ka kontraste të theksuara të lartësive, me qafa të kalueshme dhe lugina të thella që përshkohen nga lumenj të vegjël e që banojnë deri në thellësi të tyre. Në Alpe gjenden dy fshatra piktoresk, Valbona (fshati nga buron lumi Valbona) dhe Currajt e Epërm në krahinën e Nikaj Mërturit.

Një ndër atraksionet kryesore të Tropojës, por edhe të Shqipërisë, është Lugina e Valbonës që është Park Natyror Kombëtar. Ajo është zona malore më e vizituar në Shqipëri pas Thethit. Ajo vizitohet masivisht nga turistë të huaj dhe vendas. Ngjitja në ujëvarën dhe përgjatë lumit të Valbonës është një ndër eskursionet më popullore. Lugina e Valbonës e ka marrë emrin nga lumi i Valbonës që është rreth 50 km i gjatë dhe nis nga Qafa e Valbonës dhe përfundon në luginën e Drinit, pranë digës së hidrocentralit të Fierzës. Prurjet mesatare në Dragobi dhe Gri janë përkatësisht 12.2 m³/sekondë dhe 33.3 m³/sekondë. Lumi ka ujë të ftohtë dhe të kulluar, më të pastrin në Shqipëri, ujëvara—veçanërisht ujëvara e Rragamit është një mrekulli e natyrës—dhe ka krijuar kanione piktoreske. Lumi i Valbonës është i pasur me “troftën pikaloshë”. Përgjatë luginës së Valbonës janë ndërtuar dhe/ose adaptuar disa hotele dhe shtëpi pritëse për turistët. Parku Natyror Kombëtar i Valbonës ndodhet 23 km larg nga qyteti i Bajram Currit.

Në Luginën e Valbonës, hotelet dhe shtëpitë pritëse gatujnë dhe shërbejnë gatime tradicionale si maza, flija, mishi i pjekur i qingjit dhe kecit, etj.

Atraksione të tjera të rëndësishme janë kanioni i Shoshan (3 km larg Bajram Currit) dhe luginat e lumejve të Currajt, Gashit dhe Tropojës. Tropoja ka një ndër vargmalet më të bukura në Shqipëri dhe rajon.

Zona e Tropojës ka etnografi dhe folklor të pasur. Kostumet popullore janë të bukura dhe të larmishme në ngjyra dhe motive, veçanërisht ato të grave. Elementët më të përhapur të veshjes popullore janë tek burrat tirqit e bardhë me gajtana të zi dhe kapuçi i bardhë dhe tek gratë pështjellaku i gjerë ku mbizotëron ngjyra e kuqe dhe xhubleta (në Nikaj-Mërtur). Vallet e Tropojës shquhen për dinamizmin, epizmin dhe lirizmin e tyre.

Në qëndër të qytetit Bajram Curri ngrihet ndërtesa e Muzeut Historik të rrethit që dallohet për arkitekturën karakteristike, të ngjashme me atë të kullave të Malësisë së Gjakovës. Pranë muzeut ngrihet dhe statuja e Heroit të Popullit Bajram Curri.

Malësia e Gjakovës ka një kontribut të shquar në luftërat e popullit shqiptar për pavarësi dhe liri.

Pas reformës territoriale Bashkia Tropoje përbëhet nga tete njësi administrative të cilat janë Bajram Curri, Fierza, Margegaj, Bytyçi, Lekbibaj, Bujani, Tropoja dhe Llugaj. Bashkia e re tashmë ka dy qytete (Bajram Curri dhe Fierza) dhe 68 fshatra. Përfshin një territor me një sipërfaqe prej 1,043 km², dhe një popullsi prej rreth 28240 banorë të regjistruar dhe 412 biznese.

Vendosur në Shqipërinë Veri-Lindore, Tropoja është një nga rajonet më pak të njohura të vendit. Territori i saj malor mbetet gjerësisht i panjohur për shumicën e shqiptarëve, por ka fituar vëmendjen e turistëve të huaj, veçanërisht *hiker-ve* evropianë, që e vizitojnë rajonin për të shijuar kushtet e tij natyrore të paprekura dhe shtigjet alpine.

Mundësia për të krijuar vizionin e ardhshëm për Tropojën është një mundësi unike për të ngritur strategji, veprime dhe projekte konkrete që e bëjnë Tropojën një rajon unik, ku zhvillimi i ardhshëm socio-ekonomik bazohet në ndërlidhjen e kujdesshme midis përmirësimit, mbrojtjes dhe përdorimit të resurseve të saj territoriale.

Vizioni për të ardhmen e Tropojës bazohet në leximin e kujdesshëm të aseteve lokale të rajonit dhe në të kuptuarit se shfrytëzimi i tyre duhet të bëhet në përfitim të ekonomisë dhe popullsisë vendase, pa cënuar vlefshmërinë dhe mundësinë e përdorimit të tyre në të ardhmen.





Figura 1: Harta treguese Bashkia Tropoje

1.3. Demografia


Tropoja ka një popullsi prej 20,491 banorë (sipas censusit te vitit 2011). Ka një ndryshim të ndjeshëm midis të dhënave të censusit dhe numrit të popullsisë së regjistruar prej 28,216 (në vitin 2014). 75% e popullsisë jeton në zonat rurale. Dendësia mesatare e popullsisë është 20 banorë për km². Ndonëse kanë një territor relativisht të madh, komunat e Tropojës kanë një popullsi të vogël. Popullsia mesatare për njësi vendore është 2,536 banorë, shumë e ulët krahasuar jo vetëm me mesataren kombëtare (8,016 banorë) por edhe me atë të Qarkut të Kukësit (3,159 banorë). Më shumë se 25% e popullsisë banon në Bashkinë e Bajram Currit që ka një dendësi relativisht të lartë krahasuar me komunat--1749 banorë/km². Njësitë e Qeverisjes Vendore përreth Bashkisë Bajram Curri kanë dendësi më të lartë të popullsisë (rreth 33 banorë/km²) se ato më periferike (nën 28 banorë/km²). Njësitë më të vogla të Qeverisjes Vendore nga pikëpamja e popullsisë janë komunat Lekbibaj dhe Bytyç përkatësisht 1,207 dhe 1,563 banorë. Grafiku 1, 2&3 dhe Harta 2 japin të dhëna për dendësinë e popullsisë sipas NJQV-ve. Sipërfaqja relativisht e madhe, territori malor, dhe dendësia e vogël e popullsisë kanë bërë që banorët e komunave të largëta të kenë problem me ofrimin e shërbimeve publike.

Grafiku 1: Popullsia sipas NJQV-ve




Grafiku 3: Dendësia e popullsisë sipas NJQV-ve

Grafiku 2: Sipërfaqja e NJQV-ve



Harta 2: Dendësia e popullsisë sipas NJQV-ve



1.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Burimi i informacionit: **Plani i Përgjithshëm Vendor / Plani i Zhvillimit Strategjik (PPV/PZ)**

Nga pikëpamja e tipologjisë së zonave funksionale, Bashkia Tropoje, mund të konsiderohet zonë funksionale sipas modelit koncentrik. Zona funksionale përputhet me kufijtë e rrethit të Tropojës. Në qendër të zonës është Bashkia Bajram Curri që është tregu kryesor, qendra më e rëndësishme administrative dhe vendi ku ofrohen shumica e shërbimeve. Intensiteti i ndërveprimit është më i lartë midis qendrës—Bajram Currit—dhe NJQV-ve më afër saj. Dendësia e popullsisë në qendrën administrative—Bashkia Bajram Curri—është shumë më e lartë se sa në komuna. Dendësia e popullsisë jashtë qendrës ulet me rritjen e largësisë nga qendra.

Nga pikëpamje ekonomike, Tropoja është kryesisht një zonë bujqësore dhe blegtorale. Kohët e fundit ka marrë një zhvillim të konsiderueshëm turizmi malor. Minierat janë një sektor me potencial zhvillimi në të ardhmen.

Kulturat kryesore bujqësore që kultivohen janë drithërat e bukës—misri dhe gruri. Kulturat tjera janë perimet, vreshtat dhe drurët frutorë. Ndër drurët frutorë, më i përhapuri është kumbulla, veçanërisht “kumbulla e zezë” tropojane, molla “gjylalle” dhe sidomos gështenja që është një ndër produktet më të rëndësishëm për sa i përket të ardhurave që mund të gjenerojnë. Një vend të rëndësishëm në të ardhurat lokale zenë edhe bimët medicinale, veçanërisht boronica. Në blegtori mbizotërojnë të leshtat. Delja “bardhoke” është e përmendur për prodhimtari të lartë të leshit, qumështit dhe mishit. Mbarështohen edhe dhitë, lopët, kuajt, pulat, dhe derri. Kullotat a pasura luajnë një rol të rëndësishëm në prodhimin dhe cilësinë e produkteve blegtorale. Bleshkët e Gashit, Krasniqes dhe Bytyçit janë të pasura me kullota alpine. Bletaria, gjithashtu, është e përhapur në Tropojë. Është i njohur mjalti i Zogajve (Bytyçit) dhe i gështenjës (Krasniqe). Sidoqoftë, prodhimi bujqësor dhe blegtoral është i destinuar kryesisht për plotësimin e nevojave të familjeve individuale në fshat dhe qytetin e Bajram Currit. Një pjesë e prodhimit bujqësor dhe blegtoral shkon për të plotësuar nevojat e hoteleve dhe shtëpive pritëse që janë ndërtuar përgjatë Luginës së Valbonës dhe në qytetin e Bajram Currit. Vetëm një pjesë e vogël e këtij prodhimi është e destinuar për tregun kombëtar apo atë të Kosovës.

Turizmi malor është sektor kryesor. Ai është zhvilluar kryesisht në Luginën e Valbonës. Në këtë Luginë janë ndërtuar rreth 24 hotele dhe shtëpi pritëse. Turistët që vizitojnë Valbonën

vijnë nga zonat e tjera të vendit por edhe nga jashtë, kryesisht Europa Qendrore. Ata vizitojnë Luginën e Valbonës, që është një ndër mrekullitë e natyrës shqiptare, por edhe ngjiten në male duke kaluar shpesh edhe nga Lugina e Valbonës në Theth. Hotelet dhe shtëpitë pritëse servirin kryesisht gatime tradicionale duke përdorur për këtë qëllim prodhime lokale bujqësore dhe blektorale. Në këtë kontekst sektorët e bujqësisë/blektorisë dhe turizmit malor janë të ndërlidhur ngushtë dhe mbështesin njeri-tjetrin. Ka një potencial të madh për zhvillimin e turizmit malor edhe në zona të tjera të Tropojës por edhe për zhvillimin e mëtejshëm të tij në Luginën e Valbonës. Përmirësimi i shërbimit për turistët qoftë në sasinë/shumëllojshmërinë e tyre ashtu edhe në cilësinë e tyre është një kusht për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit dhe shndërrimin e tij në një burim thelbësor të ardhurash për popullsinë e Tropojës.

Minierat janë një tjetër sektor potencial i rëndësishëm. Sektori i industrisë është pak i zhvilluar. Vendin më të rëndësishëm e zë nxjerrja e mineralit të kromit në zonën minerare Rragam-Kam-Kepenek-Zogaj dhe nxjerrja e kuarcit në fshatin Kërnajë. Zona e Bytycit ka rezerva të mëdha të kromit. Por nxjerrja është e kufizuar. Ky sektor mund të jetë një sektor i rëndësishëm për ekonominë lokale. Zhvillimi i sektorit të minierave nuk do të ndikonte negativisht në zhvillimin e turizmit sepse ato janë të përqëndruara në rajone të ndryshme të zonës funksionale.

Vetëm 17 km larg qytetit Bajram Curri, aty ku bashkohet Valbona me Drinin, është ndërtuar Hidrocentrali i Fierzës (1978) që është një nga veprat më të mëdha energjetike në vend. Nga ndërtimi i tij është formuar liqeni artificial i Fierzës me një vëllim rreth 2.5 miliard metër kub ujë dhe një pellg ujëmbledhës prej rreth 11.829 km².

Megjithë pasuritë e shumta natyrore, Tropoja është një ndër zonat më të varfëra të vendit. Papunësia është në nivele të larta dhe një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave për familjet lokale vijnë nga emigracioni dhe asistencë ekonomike. Sidoqoftë, Zona Funksionale Tropojë është një zonë kryesisht bujqësore dhe blektorale me një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit malor si dhe industrisë minerare.

1.2 Çështjekryesore për projektet dhe politikat e bashkisë

Burimi i informacionit: PPV/PZhS

- Zona e Tropojës ka potenciale të pashfrytëzuara si përsa i përket tokës bujqësore të papunuar. Gjithashtu edhe rendimenti në bujqësi dhe blegtori është relativisht i ulët. Potenciali prodhues i Tropojës është të paktën dyfishi i prodhimit të tanishëm. Në ardhmen, vëmendja duhet të përqëndrohet si në rritjen e sipërfaqës së punueshme ashtu dhe ndërmarrjen e masave për rritjen e rendimentit. Duhet të mbahet parasysh që përpjekjet për rritjen e rendimentit nuk duhet të çënojnë cilësinë e produkteve.
- Duke pasur parasysh rëndësinë në rritje të turizmit malor, është e nevojshme që struktura e sipërfaqes së tokës bujqësore të orientohet drejt plotësimit të nevojave të turizmit malor. Kjo njëkohësisht do të sillte të ardhura më të larta për familjet fermere dhe do të siguronte furnizimin e sektorit të turizmit me produkte bujqësore dhe blegtorale natyrore dhe cilësore. Në këtë kontekst, mund të rritet pesha specifike e tokës së mbjellë me perime dhe kultura për ushqimin e blegtorisë. Vëmendja mund të përqëndrohet në ndërmarrjen e masave për orientimin e fermerëve.
- Në përgjithësi, prodhimi bujqësor dhe blegtoral përdoret për plotësimin e nevojave individuale të familjeve fermere dhe të Bajram Currit. Një pjesë e tyre përdoret për të plotësuar nevojat e banorëve të qytetit të Bajram Currit dhe turizmit në Luginën e Valbonës. Tregëtimi i tyre bëhet në kushte primitive nëpër rrugë. Bajram Curri nuk ka ndonjë treg të sistemuar dhe organizuar të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Një pjesë e vogël tregëtohet jashtë rrethit (Shqipëri apo Kosovë). Është e rëndësishme që të mbështeten fermerët për të dalë në treg. Gjithashtu, duhet të mbështeten përpjekjet për grumbullimin, përpunimin e marketimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Ndërtimi i një tregu ku fermerët tropojanë mund të shesin produktet bujqësore dhe blegtorale është e rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë dhe rritjen e të ardhurave të fermerëve. Zhvillimi i brand-it të Tropojës do të ishte një hap i rëndësishëm. Kjo do të ndikonte drejtpërsëdrejti në sigurimin e standarteve të sigurisë dhe cilësisë dhe rritjen e të ardhurave nga shitja e produkteve.
- Mbledhja dhe tregëtimi i gështenjës është një nga burimet kryesore të të ardhurave për ekonomine lokale. Formalizimi i pronësisë mbi masivet e gështenjës do të ndikonte pozitivisht në menaxhimin e tyre dhe rritjen e prodhimit. Është e rëndësishme që të kryhen shërbime në kulturën e gështenjës për të luftuar sëmundjet.
- Bimët medicinale janë një burim i rëndësishëm të ardhurash për buxhetin familjar për shumë familje në Tropojë dhe mund të jenë një sektor i rëndësishëm në të ardhmen duke shtuar sasinë dhe nivelin e përpunimit.
- Tropoja ka një inventar të kufizuar të mekanikës bujqësore që shpjegohet kryesisht me pamundësinë financiare të fermerëve dhe përmasave të vogla të fermës bujqësore e kombinuar me mungesën e kooperimit midis fermerëve. Gjithashtu edhe sistemi ekzisues i ujitjes është i degraduar, i pa mirëmbajtur, dhe nuk i përballon nevojat e fermerëve. Kjo ka ndikuar edhe në rendimentin e prodhimit si dhe lënien djerrë të tokave. Mbështetja e

fermerëve (nëpërmjet kreditimit me kushte lehtësuese për shembull) për të rritur përdorimin e mekanikës bujqësore do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e prodhimit dhe të ardhurave të fermerëve. Përmirësimi i sistemit të ujitjes është i nevojshëm për rritjen e tokës së mbjellë dhe të rendimentit. Gjithashtu e rëndësishme është nxitja e kooperimit midis fermereve.

- Interesi i familjeve bujqësore për shtimin e të dhirtave duhet të mbështetet pasi kullotat natyrore janë të përshtatshme dhe kanë kapacitet mbajtës trefish më shumë se sa aktual. Produktet belgtorale të të dhirtave janë shumë të kërkuara nga sektori i turizmit.
- Tropoja si rreth është e njohur edhe për bletarinë. Megjithatë rendimenti është relativisht i ulët. Futja dhe adoptimi nga bletarët i metodave bashkëkohore do të siguronte rritjen e rendimentit. Përdorimi efektiv i subvencioneve nga shteti është gjithashtu i rëndësishëm.
- Tropoja ka kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Por, zona e Tropojës po përballet me mungesën e burimeve njerëzore në bujqësi dhe blegtori kryesisht për shkak të largimit të të rinjve nga fshati. Gjithashtu, në Tropojë ka burime njerëzore të pamjaftueshme dhe të pakualifikuara për bujqësi dhe blegtori. Zhvillimi i tyre është shumë i rëndësishëm. Duhet të rritet niveli kulturor dhe profesional i specialistëve dhe fermerëve në rrethin Tropojës.
- Është e nevojshme të inkurajohet organizimi i fermerët në shoqata.
 - Aplikimi me efektivitet i skemave të mbështetjes financiare për fermerët është e rëndësishme për rritjen e prodhimit bujqësor.

1.2 Informacion financiar Kryesor

Burimi i informacionit: Nxjerrë nga Instrumentii Planifikimit Financiar

2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territorial

Burimi i informacionit: PPV/PZhS

1 | PLANI I ZHVILLIMIT

1.1 Ndarja e territorit në pesë sisteme territoriale

1.2 Ndarja e territorit në njësi strukturore

1.3 Zonimi sipas kategorive bazë dhe nënkategorive të përdorimit të propozuar të tokës

2 | ZONA DHE OBJEKTE TË RËNDËSISË KOMBËTARE DHE TERRITORET FQINJE

2.1 Burime mjedisore në territorin e bashkisë së Tropojës

- 2.2 Trashëgimia kulturore në territorin e bashkisë së Tropojës
 - 2.3 Elemente të tjera të rëndësisë kombëtare
 - 2.4 Përmirësimi i ndërveprimit
- 3 | PLANI I MBROJTJES SË MJEDISIT
- 3.1 Mbrojtja e peizazhit

- 3.1.1 Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në nivel objektivash strategjike
 - 3.1.2 Udhëzimet dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin
Mjedisor 12
- 3.2 Mbrojtja e burimeve ujore, habitateve ujore dhe cilësisë së tokës
 - 5.2.1 Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në nivel objektivash strategjike
 - 5.2.2 Udhëzimet dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat
Mjedisore 1, 2 dhe 5
- 3.3 Mbrojtja e natyrës (biodiversiteti dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbra urbane)
 - 3.3.1 Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në nivel objektivash strategjike
 - 3.3.2 Ripyllëzimi
 - 3.3.3 Brezi i Gjellbër Evropian
 - 3.3.4 Udhëzimet dhe masat zbutëse për mbrojtjen e natyrës
(biodiversiteti dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbra urbane)
- 3.4 Përmirësimi i Cilësisë së Ajrit
 - 3.4.1 Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në nivel objektivash strategjike
 - 3.4.2 Udhëzimet dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin
Mjedisor 3
- 4.5 Hotspot-e
- 5 | RUAJTJA E ASETVE KULTURORE
 - 5.1 Parashikime për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore
 - 5.2 Ruajtja dhe përmirësimi i monumenteve kulturore
- 6 | PËRMIRËSIMI I MJEDISIT BUJQËSOR
 - 6.1 Parashikime për mbrojtjen e tokës bujqësore
 - 7.1.1 Rehabilitimi i tokave të braktisura me agro-pylltari dhe permakulturë

6.1.2 Ripërdorimi i tarracave

6.2 Infrastruktura bujqësore

6.3 Pajimi bujqësor

8 | PLANI PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT

7.1 Zhvillimi turistik në rajon

7.2 Menaxhimi i shtigjeve

7.3 Shtigjet dhe pajisjet për turizmin e butë

| PLANI I MASAVE NË RRJETIN RRUGOR DHE TRANSPORT

8

Rrjeti rrugor

8.1

8.1.1 Hyrja për në territorin e bashkisë Tropojë

8.1.2 Përcaktimi i Politikave të Zhvillimit të Rrjetit Rrugor mbi bazën e Planeve Kombëtare

8.1.3 Zhvillimi i rrjetit rrugor në Bashkinë e Tropojës

8.1.4 Parkimi

9.2 Propozimet për transportin public

9.2.1 Transporti publik rrugor

9.2.2 Transporti publik ujor

9.2.3 Terminali i pasagjerëve

9.3 Platformë për shërbim

9.4 Rrjeti i lëvizshmërisë së butë

| ZHVILLIMI URBAN

10

- 10.1 Zhvillimi ekonomik dhe urban
- 10.2 Parashikimi dhe shpërndarja demografike e popullsisë
 - 10.2.1 Projektioni i popullsisë
 - 10.2.2 Kapaciteti mbajtës
 - 10.3.1 Vendbanimet bujqësore e blegtorale
 - 10.3.2 Vendbanimet pranë pikave të prodhimit
 - 10.3.3 Vendbanimet me qendra administrative

11 | PLANI I MASAVE PËR SHËRBIME SOCIALE DHE HAPËSIRA PUBLIKE

- 11.1 Strukturat publike
- 11.2 Qendra komunitare
- 11.3 Hapësirat publike
- 11.4 Shkollat
- 11.5 Kujdesi ndaj shëndetit

2.Orientimi afatgjatë i Bashkisë (2-3 faqe)

Objektivat Strategjike

SO1 Mbrojtja e mjedisit

Pavarësisht se parqet dhe rezervat natyrore janë të pranishëm në rajon, duke e bërë kështu një pjesë të madhe të territorit subjekt të niveleve të ndryshme të mbrojtjes, plani synon të përforcojë mbrojtjen mjedisore nëpërmjet një seri veprimesh specifike, duke vendosur në objektiv mbrojtjen e jetës së egër, përmirësimin e ekosistemit prodhues, përforcimin e mbrojtjes nga zjarri, zbutjen e ndryshimeve klimaterike (veçanërisht në lidhje me erozionin e tokës) dhe forcimin e strukturave administrative dhe menaxhuese të zonave të mbrojtura (përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit publik).

SO2 Ruajtja e aseteve kulturore dhe natyrore

Ky objektiv strategjik synon të ngrejë politika dhe rregullore të qarta për mbrojtjen e monumenteve dhe trashëgimisë kulturore të pranishme në të gjithë territorin e Bashkisë së Tropojës (përfshirë një kod të ri ndërtimi për ndërtimet e reja dhe rinovimet) dhe të fillojë një seri ndërhyrjesh që trajtojnë kullën dhe shtëpitë tradicionale malore, të ndërtuara me gure, që sot janë në rrezik.

SO3 Zhvillimi i turizmit

Zhvillimi i turizmit në zonën e Tropojës është i lidhur ngushtë me përmirësimin e tipareve të peizazhit të rajonit dhe me bashkimin e këtyre përbërësve të ndryshëm të peizazhit në një park të madh territorial. Për të arritur këtë qëllim, veprimet strategjike prekin ruajtjen dhe rehabilitimin e shumë shtigjeve historike që ende sot përshkojnë territorin, rikuperimin e ndërtesave të papërdorura, si struktura hotelesh, dhe zhvillimin e një pritjeje hoteliere të denjë në Bajram Curri, nga ku turistët do të arrijnë lehtësisht pikën e fillimit të ekskursioneve, falë një sistemi të ri publik lëvizjeje.

SO4 Përmirësimi i bujqësisë dhe blegtorisë

Bujqësia dhe blegtoria ende sot janë dy format kryesore të prodhimit në territorin e Tropojës, veçanërisht në malësitë lindore. Pavarësisht vështirësive të dekadave të fundit, këto veprimtari duhet të përforcohen dhe të mbështeten nëpërmjet investimeve në veprimtari të reja që përfshijnë të korrat alpine, rehabilitimit të infrastrukturave të braktisura bujqësore dhe nëpërmjet mbështetjes së bashkëpunimit midis fermerëve. Vlera e të korrave lokale duhet të rritet, zinxhiri i prodhimit, nga kultivimi deri te përpunimi dhe tregtimi, duhet të plotësohet, ndërkohë që prodhimet lokale duhet të bëhen të disponueshme

për vizitorët dhe duhet të jenë krenaria e rajonit të Tropojës.

SO5 Përmirësimi i aksesueshmërisë së territorit dhe lidhjet e brendshme

Aksesueshmëria në rajonin e Tropojës duhet të përmirësohet: ndërkohë që, nga njëra anë është e rëndësishme të përmirësohen rrugët kombëtare pasi, për momentin, mënyra më e mirë për të mbërritur në Tropojë nga Tirana është nëpërmjet Kosovës, nga ana tjetër, është thelbësore të përmirësohet aksesueshmëria e të gjitha pjesëve të territorit nëpërmjet një sistemi eficient të transportit publik, duke lejuar p.sh. turistët të lëvizin lirshëm midis Bajram Currit dhe pikave të shumëfishta të fillimit të ekskursioneve potenciale.

SO6 Konsolidimi i zonave urbane dhe rurale

Në kontrast me bukurinë e peizazhit, si Bajram Curri ashtu edhe qendrat rurale vuajnë nga një mungesë e hapësirës së denjë publike. Ndërkohë që, në Bajram Curri, hapësira e re publike e qytetit është parashikuar si një tërësi sipërfaqesh të shtruara që, duke ndjekur topografinë, krijojnë fragmente tarracash dhe shkallësh, në qendra më të vogla urbane, hapësira kryesore urbane është parashikuar si një trotuar këmbësorësh që lidh mjediset kryesore publike, si administrata lokale, ambulanca dhe zyra postare. Në këtë mënyrë, çdo qendër urbane do të shenjohej nga një vend specifik takimesh dhe jete qytetare.

SO7 Përditësimi dhe implementimi i infrastrukturës bazë urbane

Në mënyrë të ngjashme me shumë pjesë të tjera urbane dhe rurale të Shqipërisë, edhe rajoni i Tropojës ka nevojë për një përmirësim dhe implementim të infrastrukturave bazike urbane, si në Bajram Curri ashtu edhe në vendbanime rurale, përfshirë realizimin e një sistemi funksional kanalizimesh për të gjithë territorin e bashkisë (si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane), ndërtimin e një impianti trajtimi të ujërave të zeza në Bajram Curri dhe zhvillimin e një sistemi plotësisht funksional të hedhjes së mbeturinave.

SO8 Përmirësimi i bashkëpunimit ndër-kufitar.

Plani synon të njohë rëndësinë dhe të përforcojë bashkëpunimin ndër-kufitar me vendet fqinje, si Kosova dhe Mali i Zi, pasi është e nevojshme të krijohen ndërveprime në terma të mbrojtjes mjedisore dhe zhvillimit ekonomik.

2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit

Burimi i informacionit: PPV/PZhS; të tjera

3. Projektet kryesore të PBA-së 2020-2022

Paraqitja e projekteve kryesore–motivimi dhe përfituesit

PBA-ja është hartuar në bazë të programeve, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Dokumenti prezanton me detaje qëllimet, objektivat dhe projektet/aktivitetet për çdo program. Dokumenti është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë dhe është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit.

Investimet kryesore të Bashkisë janëpërqendruar në shtate programe: ,te cilat ne menyre te detajuar do i trajtojmë gjate dokumentit te buxhetit. Projektet ku është parashikuar të investohet për një periudhë tre-vjeçare janë:

Viti 2020

Programi	Nenfunkioni	Projekti	Arsyet/Motivimi dhe përfituesit.
011	Planifikim,menaxhim dhe administrim	Mobilim i zyrave te Bashkise	Restaurmi i Godines se Bashkise,ne vitin 2016,nuk eshte shoqeruar dhe me mobilimin e zyrave,per te mbuluar dhe shtimin e funksioneve te reja,si dhe perqendrimin kryesor te administares se Bashkise ne godinen e restauruar. Per kete eshte parashikuar nje mobilim i disa prej zyrave te Bashkise,sidomos per funksionet dhe perjegjesite e shtuara si pyje audit,bujqesi etj
045: Transporti	1. Transporti rrugor	Permiresimi i infrastruktures se rrugeve ne Lagjen “ 28 Gushti”	Lagjja “28 Gushti” eshte lagjja ne qender te qytetit, ne te cilen ndodhet edhe institucionet kryesore te administrates. Rruget dhe sheshet e kesaj lagjeje, ne te cilat eshte punuar para viteve 90, jane te amortizuara ne mase te madhe. Mungojne rruget e KUB, ndricimit rrugor, nje pjese KUZ, gjelberimi, etj. Gjendja e tille e infrastruktures se kesaj lagjeje ka sjelle veshtiresi ne qarkullimin e mjeteve e te kembesoreve dhe eshte nje pengese per kryerjen e sherbimeve te pastrimit, gjelberimit, etj. Kjo i sherben

			<p>nje komiteti te lagjes, prej 1900 banoresh.</p> <p>Ne kete lagje nuk eshte nderhyre prej 30 vitesh ,me perjashtim te vitit 2019,ku eshte nvestuar ne shumen prej 21.100 mije leke,ne segmentin kryesor te saj e konkretisht segmentin qe lidh rrugen ,prane fushes se sportit me qenderen e tregut artizanal.Ne kete investim jane perfshire ,punime te tilla si asfaltime,trotuare, ndricim publik hapesira te gjelbera,ndricim dh punime ne KUZ dhe KUB</p> <p>Ne kete kushte mendohet qe te vazhdohet me investime dhe ne vitin 2020,me nje investim prej 20.000 mije leke,per nderhyrje ne segmente te tjera te brendshme te lagjes,</p>
045: Transporti	8 Transporti rrugor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rikonstrukcion rruge ne Lagjen Dardania ,Bajram Curri 	<p>Lagja “Dardania” eshte lagje me ndertime, kryesisht te reja, te ndertuara ne fund te viteve 80, por me nje mungese te theksuar te infrastruktures rrugore dhe rrjeteve inxhinierike. Nisur nga kjo gjendje, del e nevojshme nderhyrja me fonde per te sistemuar rruget e sheshet me ane te asfaltimit te tyre dhe te ndertimit te rrjeteve te KUB, KUZ, ndricimit rrugor, krijimit te siperfaqeve te gjelberta, etj., te cilat do t'i sherbejne nje komuniteti prej 2950 banoresh</p> <p>Ne kete lagje nuk eshte nderhyre prej 30 vitesh ,me perjashtim te vitit 2019 me perjashtim te kendit te lojerave per femije te investuar ne vitin 2008,,ku eshte nvestuar ne shumen prej 11.208 mije leke,ne segmentin kryesor te saj e konkretisht segmentin qe lidh rrugen Agim Ramadani me rrugen Ram Sadria.Ne kete investim jane perfshire ,punime te tilla si asfaltime,trotuare, ndricim publik hapesira te gjelbera,ndricim dh punime ne KUZ dhe KUB.mendohet te nderhyhet me nje investim prej 15.208 mije leke per punime te tjera ne kete lagje ,per te</p>

			<p>mundesuar rehabilitimin e plote te kesaj lagje.</p> <p>.</p>
045: Transporti	8 Transporti rrugor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rikonstruksion 'Unaza e Gashit' Njesia administrative Tropoje 	<p>Nepermjet ketij programimi mundesohet vazhdimi i punimeve ne unazen e Gashit, Njesia administrative Tropoje si je nder njesite me te medha ne Bashkine e Tropojes, ne te cilin ne kater vitet e kaluara eshte investuar vetem ne infarstrukturen e ujitjes dhe te furnizmit me uje dhe jo ne infrastrukture rrugore.</p> <p>Nepermjet investimi do te mundesohet vazhdimi i sistemim dhe shtrim ne cakull te rruges nga Fshati Kernaje ne drejtim te fshatit Myhejan, me vepra te tilla si zgjerime te terreneve „kanale pritese te ujerave te larte, vendosje turbinash ,vendosje te shtyllave te ndricimit, ne qendern e fshatit.</p> <p>Ky investim shte parashikuar ne shumen 25.541 mije leke</p> <p>Ky investim do te vazhdoje dhe ne vitete e tjera te PBA-se.</p> <p>.</p>
045: Transporti	8 Transporti rrugor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rikonstruksion 'Rikualifikim i qendres administartivce Bytyç ,’Njesia administrative Bytyç 	<p>Nepermjet ketij programimi mundesohet ,sistemim pjesor i qendres se Njesise Administrative ,ku jan eparashkuar punime te tilla rikualifikuese si, sistemim i kanaleve te ujerave te shiut, asfaltim i shtresave te demtuara te asfaltit, punime ne sistemin e ndricimit etj</p> <p>Ky investim eshte programuar ne vleren 8.000 mije leke.</p> <p>.</p>

042-Bujqesia ,pyjet peshkimi dhe gjuetia	7.Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	<ul style="list-style-type: none"> Rikonstruksion kanale vaditese,Bashkia Tropoje, Kanli I Gashit 	<p>Nepermjet ketij investimi mundesohet,permiresim i sistemit te ujitjes per banoret e zonave qe mbulohen nga Veprat ujitese, te Gashit,</p> <p>Sqarojme qe punimet,qe do parashikohen jane vazhdim i punimeve ne keto segmente te bera ne tre vitet e fundit.</p> <p>Shuma e parashikuar eshte 20.000 mije leke.</p>
064	Ndriçimi i rrugeve	Rikonstruksion I rrjetit te ndricimit rrugor	<p>Me kete investim eshte parashikuar qe te restarohet ndricimi rrugor ne Rrugët kryesore te qytetit,kryesht ne rrugen Ram Sadria./</p> <p>Fondi i parashikuar eshte 5.000 mije leke.</p>
092-Arsimi i mesem dhe sherbimet mbeshtetese	21-Arsimi i mesem	Bashkfinancim per palester dhe trrene sportive te Gjmnazit "Asim Vokshi" Bajram Curri	<p>Nepermjet ketij investimi synohetndertimi i palestres dhe terreneve sportive te kesaj shkolle,Investimi nen kete program perfaqeson vetem pjesen e bashkfinancimit me Fondin Shqiptar te Zhvillimit,per kete objekt.Rikonstruksioni i shkolles s emesme eshte realizuar gjate vitit 2018-2019.</p>
106-Strehim social	Strehim social	Bashkfinancim per pojekte ne funksion te projekteve per ndertim qendrash komunitare.	<p>Eshte menduar nje fon simbolik ,per raste e projekteve qe kerkojne bashkfinancime per punime ndertimore.</p> <p>Eshte parashikuar nje fond prej 850 mije leke.</p>

Viti 2021

Programi	Aktiviteti	Projekti	Arsyet/Motivimi dhe përfituesit.
045: Transporti	8 Transporti rrugor	<ul style="list-style-type: none"> Rikualifikim urban "Lagje Partizani",Faza e dyte. 	<p>Nepermjet ketij programimi mundesohet vazhdimi i punimeve ne rikualifikimin e lagjes " Partizani",Faza e dyte.</p>

			<p>Gjate vitit 2013 eshte investuar ne sistemim asfaltim te rruges kryesore ne kete lagje por vetem ne pjesen Markate,deri ne pjesen fundore te kesaj lagje ,por pa kaluar ne segmentin e rruges "Bylbil Breçani"Me kete investim synohet sistemim – asfaltim i segmentit te rruges nga Pallati i Kultures dh bashkij me pjesen e sipermet te lagjes" Partizani"</p> <p>Do te kryhen punime te investimi ne trotuare,ndricimi KUZ dhe KUB.</p> <p>Shuma e investimit parashikohet 34.549 mije</p> <p>Ky investim do te vazhdoje dhe ne vitete e tjera te PBA-se.</p> <p>.</p>
045: Transporti	8-Transporti rrugor	<ul style="list-style-type: none"> Rikonstruksion "Unaza e Gashit" Faza e dyte 	<p>Nepermjet ketij investimi synohet qe te vazhdoje sistemim asfaltim i Rruges auto qe lidh Fshati Kernnaje-Kovac –Myhejan-Tropoje e vjeter.Fondi ne dispozicion do te jte 30.000 mije leke.</p> <p>Ky investim d te vazhdoje dhe ne vitin 2022</p>
042-Bujqesia ,pyjet peshkimi dhe gjuetia	7.Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	<ul style="list-style-type: none"> Rikonstruksion Kanali vadites i Shoshanit 	<p>Nepermjet ketij investimi,synohet permiresimi i infarstruktures ujitesese te Fshatit Shoshan ,Lagje e Paqes</p> <p>Shuma e investimit parashikohet ne 30.000 mije leke..</p>
064	Ndriçimi i rrugëve	Rikonstruksion I rrjetit te ndricimit rrugor	<p>Me kete investim eshte parashikuar qe te restarohet ndricimi rrugur ne Rruget kryesore te qytetit,kryesht ne rrugen Agim Ramadani,dhe</p>

			Beselidhja e Malesise. Fondi i parashikuar eshte 5.000 mije leke.
091-Arsimi baze dhe parashkollor	21-Arsimi baze	Rikonstrukcion I kopshtit nr 1.	Nepermjet ketij programimi, synohet permiresimi i infrastruktures arsimore dhe kushteve higjenosanitare ne kopshtin nr 1, Lagjen Partizani. Kjo ndertese eshte trekateshe dhe nuk eshte nderhyre me asnje investim qe ne vitet .85. Ka nevojte per nje restaurim te pergjithshem.. Shuma e programuar eshe 10.800 mije leke.
106-Strehim social	Strehim social	Bashkfinancim per pojekte ne funksion te projekteve per ndertim qendrash komunitare.	Eshte menduar nje fon simbolik ,per raste e projekteve qe kerkojne bashkfinancime per punime ndertimore. Eshte parashikuar nje fond prej 850 mije leke.

Viti 2022

Programi	Aktiviteti	Projekti	Arsyet/Motivimi dhe perfituesit.
045: Transporti	8 Transporti rrugor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rikonstrukcion rruge ne Lagjen Dardania ,Bajram Curri 	Lagjja "Dardania" eshte lagje me ndertime, kryesisht te reja, te ndertuara ne fund te viteve 80, por me nje mungese te theksuar te infrastruktures rugore dhe rrjeteve inxhinierike. Nisur nga kjo gjendje, del e nevojshme nderhyrja me fonde per te sistemuar rruget e sheshet me ane te asfaltimit te tyre dhe te

			<p>ndertimit te rrjeteve te KUB, KUZ, ndricimit rrugor, krijimit te siperfaqeve te gjelberta, etj., te cilat do t'i sherbejne nje komuniteti prej 2950 banoresh</p> <p>Mendohet qe ne vitin 2022,te nderhyhet ne rruget dytesore te lagjes me sistemime asfaltime,ndricim KUZ dhe KUB.Shuma e programuar per vitin 2022 do te jete15 565 mije leke</p>
045: Transporti	8 Transporti rrugor	<ul style="list-style-type: none"> Rikonstruksion rruge ne Lagjen Dardania ,Bajram Curri 	<p>Do te vazhdohet me sistemime te te segmenteve tetjera te ksaj lagje ,sidomos ne pjesen me se dy rrugeve Beselidhja e Malesise dhe Mic Sokoli,ne te cilen nuk eshte nderhyre asnjehere,,Shuma e planifikuar eshte 20.000 mije leke.</p> <p>Parashikohen, punime te infrastruktures teresore,te kesaj pjese te lagjes si sisstmim,gjelberim ndricim KUZ dhe KUB.</p>
045: Transporti	8 Transporti rrugor	<ul style="list-style-type: none"> Rikonstruksion Rruga T,pla Moken Dege,Njesia administartive Fierze. 	<p>Ne kete rruge nuk eshte nderhyre asnjehere .</p> <p>Jane parashikuar sistemime zgjerim dhe shtrim transhe, me qellim vazhdimin e procedurave te mevonshme ne sistemim dhe asfaltim</p> <p>Parashikohet punime ne nje segment rreth 6.7 km rruge.</p> <p>Punimet do te perfshijne dhe ndertimin e tre veprave te artit.</p> <p>Prashikohet nje fond prej 10.000 mije leke</p> <p>.</p>
045: Transporti	8 Transporti rrugor	<ul style="list-style-type: none"> Rikualifikikim urban "Lagje Partizani",Faza e trete. 	<p>Nepermjet ketij programimi mundesohet vazhdimi i punimeve ne rikualifikimin e lagjes " Partizani",Faza e trete</p> <p>Shuma e investimit parashikohet 27.585 mije</p>

			<p>Ky investim do te vazhdoje dhe ne vitete e tjera te PBA-se.</p> <p>.</p>
045: Transporti	8 Transporti rrugor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rikonstruksion 'Unaza e Gashit"Njesia administrative Tropoje-Faza 3 	<p>Nepermjet ketij programimi mundesohet vazhdimi i punimeve ne unazen e Gashit,Njesia administrative Tropoje si je nder njesite me te medha ne Bashkine e Tropojes,</p> <p>Nepermjet ketij investimi synohet te procedohet me punime asfaltuese .</p> <p>Parashikohet nje fond prej 20.000 mije leke.</p> <p>.</p> <p>.</p>
042-Bujqesia ,pyjet peshkimi dhe gjuetia	7-.Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	<ul style="list-style-type: none"> • Rikonstruksion Kanali vadites i Shoshanit. 	<p>Nepermjet ketij investimi permiresohet infarstruktura e ujitjes se fshatit shoshan,Cernice.</p> <p>Eshte parashikuar fondi prej 25.800 mije leke.</p>
064	Ndriçimi i rrugeve	Rikonstruksion I rrjetit te ndricimit rrugor	<p>Me kete investim eshte parashikuar qe te restarohet ndricimi rrugur ne Rrugët kryesore te qytetit,kryesht ne rrugen Mic Sokoli dhe Sylejman Vokshi.</p> <p>Fondi i parashikuar eshte 5.000 mije leke.</p>
091	Arsimi baze	Punime ndertimore ne shkollat Cernice,Babine,Tropoje.	<p>Jane parashikuar punime ndertimore,ne keto sholla,pasi nuk eshte investuar krahasimisht shume pak ne keto objekte.\</p> <p>Jane parasikuar punime ne nyjet sanitare,dyer dhe dritare,</p> <p>Fondi i parashikuar eshte 10.765 mije leke</p>

106-Strehim social	Strehim social	Bashkfinancim per pojkete ne funksion te projekteve per ndertim qendrash komunitare.	Eshte menduar nje fon simbolik ,per raste e projekteve qe kerkojne bashkfinancime per punime ndertimore. Eshte parashikuar nje fond prej 850 mije leke.
--------------------	----------------	--	--

3.1 Paraqitja e projekteve kryesore–arsyet dhe përfituesit

Burimi i informacionit: Fishat e projekteve të PPV/PZhS

1..SISTEMIME LAGJE “28 GUSHTI”, BAJRAM CURRI

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	Bashkia Tropoje	Firma e propozuesit te Projektit	
Te dhena te detajuara per propozuesin e projektit	Drejtoria Planifikim Zhvillim Territorit		
Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori	Bashkia Tropoje	Vendodhja e Projektit	Bashkia Tropoje NjA B.Curri

02. Identifikimi i Idese se Investimit

Projekt Idea	
Problemet per tu adresuar	Lagjja “28 Gushti” eshte lagjja ne qender te qytetit, ne te cilen ndodhet edhe institucionet kryesore te administrates. Rruget dhe sheshet e kesaj lagjeje, ne te cilat eshte punuar para viteve 90, jane te amortizuara ne mase te madhe. Mungojne rrjetet e KUB, ndriçimit rrugor, nje pjese KUZ, gjelberimi, etj. Gjendja e tille e infrastruktures se kesaj lagjeje ka sjelle veshtiresi ne qarkullimin e mjeteve e te kembesoreve dhe eshte nje pengese per kryerjen e sherbimeve te pastrimit, gjelberimit, etj. Kjo i sherben nje komiteti te lagjes, prej 1900 banoresh.
Emri i Programit	Infrastrukturë rrugore (P4/F1)
Qellimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen	Qellimi:Te rritet cilesia e sherbimeve per banoret e lagjes Objektivi: Përmirësimi i ambientit urban, rrugeve, shesheve, etj., nepermjet kryerjes se punimeve, si: Shtresa asfaltike ne nje gjatesi rrugore prej 480 ml

	<p>Rrjet ndriçimi rrugor ne gjatesi 480 ml</p> <p>Rrjete te KUB dhe KUZ ne gjatesi 480 ml</p> <p>Ndertim mure pritese e mbajtese dhe sistemim e krijim i siperfaqeve te gjelberta.</p>
--	--

0.3. Kostot e Projektit te Investimit

Kosto e zbatimit	19.504
Kosto kolaudim supervizim	496
Kosto e projektimit	
Kosto Totale e Projektit	
000/leke	20.000

2. SISTEMIME LAGJE “DARDANIA”, BAJRAM CURRI

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	Bashkia Tropoje	Firma e propozuesit te Projektit	
Te dhena te detajuara per propozuesin e projektit	Drejtoria Planifikim Zhvillim Territorit		
Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori	Bashkia Tropoje	Vendodhja e Projektit	Bashkia Tropoje NjA B.Curri

02. Identifikimi i Idese se Investimit

Projekt Idea	
Problemet per tu adresuar	Lagjja “Dardania” eshte lagje me ndertime, kryesisht te reja, te ndertuara ne fund te viteve 80, por me nje mungese te theksuar te infrastruktures rrugore dhe rrjeteve inxhinierike. Nisur nga kjo gjendje, del e nevojshme nderhyrja me fonde per te sistemuar rruget e sheshet me ane te asfaltimit te tyre dhe te ndertimit te rrjeteve te KUB, KUZ, ndriçimit rrugor, krijimit te siperfaqeve te gjelberta, etj., te cilat do t'i sherbejne nje komuniteti prej 2950 banoresh.
Emri i Programit	Infrastrukturë rrugore (P4/F1)
